




REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <b>2-D/DPK</b>	Nr Prot. Br Prot. <b>01-3363/13</b>
Nr. i faq. Broj stranica <b>02</b>	Data Datum <b>14.10.2013</b>
PRISHTINE	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d) si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.10.2013, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-2641/13, për z. Nezir Klinaku – Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Vushtrrisë, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr.AKK- 03-2641/13, për Zyrtarin e Lartë, z. Nezir Klinaku, Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Vushtrrisë dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.**

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Klinaku është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit ( me datë 10.09.2013), pas së cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë. Me këtë rast ai është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet të cilat duhet të bëj për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Klinaku, në këtë takim ka deklaruar se brenda afatit ligjor do të deq dorë nga të qenurit person i autorizuar në biznes privat dhe do të vazhdoj të ushtroj funksionin e tij publik.

Ndërkohë, z. Klinaku ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë( DPKI.03- 3166/13) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka hequr dorë nga pozita e personit të autorizuar që kishte në Auto Shkolla "Lumi", për të ushtruar funksionin e tij publik në Komunën e Vushtrisë, me çka ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së ;
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës).

Hasan Preteni  
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

